

VENDIM
Nr.768, datë 16.11.2006

PËR HAPJEN E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE “MASTER” PRANË FAKULTETIT TË INXHINIERISË ELEKTRIKE TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 35 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e ciklit të dytë të studimeve “Master” pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike të Universitetit Politeknik të Tiranës, në degët:

- Inxhinieri elektronike;
- Inxhinieri informatike;
- Inxhinieri telekomunikacioni.

2. Kohëzgjatja e ciklit të dytë të studimeve “Master”, në degët e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të jetë dy vjet dhe ngarkesa mësimore vjetore të jetë jo më pak se 60 kredite. Sistemi i studimeve të jetë me kohë të plotë.

3. Tarifa vjetore e shkollimit për këto degë të jetë 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë. Kuotat e pranimit përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për çdo vit, në mbështetje të propozimeve të Universitetit Politeknik të Tiranës.

4. Tarifa e shkollimit për studimet “Master” për studentët, që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve universitare me mesatare 10, të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në Buxhetin e Shtetit për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe nga burime të tjera, të ligjshme, të vetë shkollës së lartë.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha